



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

NrProt.

Tiranë, më __. __. 2014

Lënda: Monitorimi i realizimit të buxhetit të 12 – muorit, të vitit 2014

Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT

TIRANË

**MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK , TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për vitin 2014 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim,
- ❖ Siguria Ushqimore,
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes,
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketing,
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor ,
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore ,
- ❖ Menaxhimi i Peshkimit.

Buxheti vjetor 2014, i planifikuar për këto 7 programe, është realizuar si 12– muor, në masën 96 përqind ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti vjetor fillestar ishte 7.899 milion, buxheti përfundimtar si 12 – muor, 6.651 milion lekë dhe është realizuar 6.359 milion lekë të detajuar sipas programeve paraqitur në tabelën e mëposhtme.


Nr	Emri i Programit	Buxheti 2014(mln lekë)	Struktura Në %	Fakti 12 mujor 2014		
				Në mln lekë %	Në % ndaj buxh	Struk në
1	Planifikim, Menaxhim , Administrim	277	4,1	253	91	4
2	Siguria Ushqimore	1837	27,6	1867	102	29
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	1553	23,3	1328	85	22
4	Zhvillimi Rural	1772	26,6	1731	98	27
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	214	3,3	193	90	3
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	20	0,3	20	100	0.3
7	Menaxhimi i Peshkimit	979	14,8	968	99	15
	Totali	6651	100	6359	96	100

Rreth 96 % e totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2014 e zënë me shpenzimet për programin “Siguria Ushqimore” me 102%, “Menaxhimi i Peshkimit” me 100 % ndaj totalit të faktit ndjekur nga programet tjera buxhetore.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2014 dhe realizimit faktik të 12 – mujorit, të vitit 2014, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Në %

Nr	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve, sipas PBA-së 2014	Struktura e shpenzimeve, sipas buxhetit 2014	Struktura e shpenzimeve faktike për vitin 2014
1	Planifikim , Menaxhim, Administrim	3.7	4,1	4
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	26.7	27,6	29
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	38.1	23,3	22
4	Mbështetja e Prodhimeve Bujqësore -Blegtorale	27.3	26,6	27
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	4.1	3,3	3
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	0.2	0,3	0.3
7	Menaxhimi i Peshkimit		14,8	15
	TOTALI	100	100	100



Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014 për këtë program, që përfaqëson rreth **91 përqind** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesore krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 91 përqind
- Shpenzimet kapitale 94 përqind
- **Gjithsej 93 përqind**

Për vitin 2014, janë parashikuar 6 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi faktik i 12 mujorit 2014		
		Në milione lekë	Ne %	Statusi i realizimit
Funksionimi i kapaciteteve, menaxhimin për implementimin e politikave bujqësore	172	157	91	Plotësisht
Ngritja profesionale e stafit	55	52	95	Plotësisht
Menaxhimi i përgjithshëm i institucionit	14	9	64	Plotësisht
Detyrime për anëtarësimin në org. ndërkombëtare	30	29	97	Plotësisht
Përmirësimi i kushteve të punës	6	6	100	Plotësisht
TOTALI	277	253	91	Plotësisht

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit janë realizuar 94 %, sigurimet shoqërore 94 %, shpenzime operative 88 %, investimet 94 %.

Ky program kishte të planifikuar 2 objekte investimi :”Furnizim ,vendosje çillera për sistemin ftohës qëndror” , i cili u realizua me 98 % dhe “Blerje paisje kompjuterike” me realizim faktik 87 % ndaj planit.

2-Programi “Siguria ushqimore”

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe ne produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivalve, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fito-sanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për periudhën 12 mujore janë përfunduar aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë e fito-sanitare, programi i monitorimeve të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në database, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të DRB-së e AKU-së .

E veçantë për vitin 2014 ishte shfaqja dhe përhapja e sëmundjes së gjuhës blu , për herë të parë në Shqipëri si rezultat i të cilës u dëmtuan dhe dëmshpërblyen një numër i madh krerësh në të imta dhe gjedhë.

Produktet e përftuara për periudhën 12 mujore, parashikuar në PBA për vitin 2014, janë realizuar si më poshtë,

- Mbi kontrollin e situatës epizootike, ka përfunduar vaksinimi kundër sëmundjes së plasjes. Ka përfunduar fushata e vaksinimit të brucelozës në të imta në bashkëpunim me projektin PAZA “ Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike”
- Nuk është parashikuar gjurmim brucelozë në të imta dhe këto produkte nuk pasqyrohen në buxhet.

- Është realizuar programi i monitorimit të mbetjeve dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujërave të brendshme sipas programit, por nuk kanë kaluar ende shpenzimet e plota. Ka përfunduar prokurimi i reagentëve, kimikateve dhe ngjyresve.
- Monitorimi i sëmundjeve ka përfunduar kryesisht për sëmundjen e bruçelozës, tuberkulozit dhe gjuhës blu.
- Për periudhën 12 mujore në fushën e mbrojtjes së bimëve janë trajtuar vetëm 44.026 rrënjë kundër mizës .
- Ka përfunduar trajtimi kundër miut të arave dhe karkalecit dhe janë trajtuar mbi 100 % e sipërfaqes së parashikuar.
- Ka përfunduar realizimi i programit të identifikimit të kafshëve, proces që vazhdon deri në identifikimin e plotë të remontit, gjedhë e të imta.
- Janë realizuar shpenzimet operative, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2014 për DRB-së , ISUV, dhe AKU .
- Janë realizuar sipas parashikimit shpenzime të investimeve në zërat TVSH dhe kosto lokale, pasi kjo lidhet me zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilëve është në proces .

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi i vitit i vitit 2014		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Legjislacion i përafuar me aktet normative të BE-së	1	1	100	Plotësisht
Kafshë të identifikuar në gjithë vendin - Gjedhë remonti	7,7	8		Plotësisht
- Të imta	23	20	91	
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në kafshë e produkte prej tyre	10	10	100	Plotësisht
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në ujëra e molusqe bivalve.	5	5	100	Plotësisht
Sëmundje në kafshë , të monitoruara - Kafshë të ujit	-	-		Plotësisht
-Kafshë të Tokës	8	8	100	Plotësisht
Derra të vaksinuar k/murtajës klasike.		6	100	Plotësisht

	6			
Të imta të vaksinuara k/ brucelozës (Rev1).	61	60	98	Plotësisht
Vaksinim kundër tërbimit	0,5	0	0	Aspak
Kafshë gjedhë të gjurmua për tuberkuloz.	7	3	43	Plotësisht
Kafshë gjedhë vaksinuar k/plasjes.	4	4	100	Plotësisht
Kafshë të imta, etj, vaksinuar k/plasjes.	16	16	100	Plotësisht
Kafshë gjedhë të eliminuara si të infektuara nga bruceloza, plasja, tuberkulozi.	24	15	63	Plotësisht
-Të imta të eliminuara	18	21	117	Plotësisht
Rrënjë ullinj dhe pemë frutore të trajtuara k/mizës dhe f. bardhë të manit.	7	7	100	Plotësisht
Pemë frutore të asgjësuara si të infektuara.	1,8	0	0	Aspak
Sipërfaqe e trajtuar k/ miut të arave dhe karkalecit.	37	37	100	Plotësisht
Zonë e lirë për prodhimin e patates e monitoruar.	1,	1	100	Plotësisht
Prodhim certifikata fitosanitare	0, 5	.0,4	80	Plotësisht
Kafshë gjedhë të gjurmuar për brucelozë.	3,5	2	57	Plotësisht
Kafshë gjedhë të vaksinuar k/brucelozës	10	10	100	Plotësisht
AKU e plotësuar me kapacitetet për funksionimin e plotë - Paga	376	364	97	Plotësisht
- operative	77	76	99	Plotësisht
- investime	0-	0-	0	Plotësisht
- trajnim, sensibilizim	0-	0-	0	Plotësisht

Instituti i Sigurisë Ushqimore i fuqizuar dhe me kapacitete të plotësuara- Paga	88	88	100	Plotësisht
- operative	24	24	100	Plotësisht
- investime	0-	0-	0	Plotësisht
DRBU-të në qarqe të plotësuara me kapacitetet e nevojshme funksionale- Paga	421	388	92	Plotësisht
- operative	100	93	93	Plotësisht
- IPA-2008-TVSH	12	12	100	Plotësisht
- IPA-2008-Kosto lokale				Plotësisht
Transferta ne buxhetet familjare	4	4	100	Plotësisht
Fuqizimi i shëndetit të njerëzve kundër zoonozave, 5 sëmundje zoonotike.(IPA 2008)	387	492	127	Plotësisht
IPA-2010 TVSH	57	56	98	Plotësisht
IPA-2010 Kosto lokale	19	18	95	Plotësisht
IPA-2012	20	18	90	Plotësisht
TOTALI	1837	1867	102	

- Referuar projekteve të investimeve të huaja si **IPA 2008 ,Komisioni Evropian, Projekti PAZA është realizuar 100%.**

Projekt i mbyllur si fazë e parë. Një nga arritjet kryesore të Projektit PAZA ka qenë harmonizimi i sistemeve ekzistuese në sektorin e blegtorisë, duke krijuar bazën e të dhënave RUDA. Baza e të dhënave RUDA përmban të dhëna mbi regjistrin kombëtar të fermave dhe të dhëna të detajuara mbi regjistrimin dhe lëvizjet e gjedhëve dhe të imtat. Sistemi RUDA përfshin edhe të dhëna vjetore mbi vaksinimet e realizuara dhe matrikullimin e përvitshëm në blegtori. Një nga veprimtaritë më të rëndësishme të realizuara nga projekti ka qenë fushata kombëtare për vaksinimin kundër brucelozës në të imta. Me bashkëfinancimin e Ministrisë është kryer procesi i vaksinimit të bagëtive të imta kundër brucelozës. Realizimi i këtyre objektivave është shoqëruar me një trajnim të strukturave publike dhe të veterinarëve privat që kanë qenë pjesë e fushatave.

➤ **IPA 2010, “Ndërtimi i Laboratorit Veterinar” realizuar 234%.**

Projekti i ka përfunduar të gjitha aktivitetet e tij. Kompania e përzgjedhur nga Komisioni Evropian, ka përfunduar tërësisht punimet sipas kontratës dhe nëpërmjet fondit të bashkëfinancimit janë kryer procedurat e prokurimit të paisjeve për këtë laborator.

➤ **IPA 2010, “Mbështetje për infrastrukturën e AKU” realizuar 159%.**

Pas përgatitjes së projekteve ndërtimore me fonde nga projekti IPA 2009, delegacioni Evropian në Tiranë përfundoi tenderin për “Punime për ndërtimin/rehabilitimin e zyrave rajonale dhe laboratorëve të AKU” (ref. EuropeAID/131838/C/ËKS/AL. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka lidhur kontratat me CEZ dhe me Ujësjellësat për lidhjen me energji e ujë për zyrat/laboratorët si dhe mobilimin e tyre. Jane ndërtuar dhe rikonstruktuar zyrat dhe laboratorët rajonal të AKU sipas projekteve të hartuar nga kompania e kontraktuar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë. Ministria ka shpenzuar rregullisht pjesën e buxhetit si pjesë e bashkëfinancimit të projektit dhe ka kryer lidhjet e nevojshme të zyrave dhe laboratorëve. Në datën 18 Dhjetor 2014 u bë inaugurimi i Godinës së Zyrave dhe laboratorëve rajonal të AKU.

➤ **IPA 2012, “Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit” realizuar 73% ,**

Projekti mbështet fushatën kombëtare për të vaksinuar të gjithë bagëtinë e imta kundër brucelozës. Faza e parë e vaksinimit është përfunduar gjatë muajit maj 2014. Projekti PAZA gjeti se programet e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve në Shqipëri lidhen me një përjasje me bazë risku si dhe ka hartuar një strategji për të kontrolluar antraksin që u përqëndrua në fshatrat ku sëmundja ishte konfirmuar nga diagnozat laboratorike. Vlerësimi përfundimtar i suksesit të fushatave të vaksinimit kundër tërbimit dhe brucelozës varen nga rezultatet e testeve laboratorike të mostrave të mbledhura nga një grup target të kafshëve si dhelprat, për të përcaktuar imunitetin ndaj tërbimit në të imta si dhe për të fituar imunitet ndaj brucelozës.

➤ **IPA 2009 “Konsolidimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” realizuar 32%.**

Ky projekt përfundoi në dhjetor 2014 duke realizuar objektivat e përcaktuara.

Ndërsa për sa i përket investimeve të brendshme të këtij programi të cilat janë kosto lokale dhe tvsh të projekteve të mësipërme janë realizuar mbi 97%.

2. Programi “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes”

Ky është një nga programet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, si një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014, për këtë program, që përfaqëson rreth 85 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	97,3	përqind
• Shpenzimet kapitale	69,5	përqind
• Gjithsej	85,5	përqind

- ❖ Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore janë realizuar 97 % të fondit vjetor të planifikuar, shpenzimet operative 97,4 %, ndërsa investimet si realizim financiar paraqitet në 69,5%.

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi i vitit 2014		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes				
Rrjeti i kanaleve kullues i mirëmbajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia)	327	318	97	Plotësisht
Rrjeti i kanaleve ujitës i mirëmbajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia)	190	185	97	Plotësisht
Argjinatura të mirëmbajtura në mënyrë rutine	28	27	97	Plotësisht
Shërbimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovore	336	328	98	Plotësisht
Inspektime teknike të sigurisë së digave	5	5	100	Plotësisht
Inspektime teknike të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja në zonën e shërbimit të ujitjes 360 000 ha dhe zonën e shërbimit të kullimit 280 000 ha përfshi dhe 28 hidrovoret	5	5	100	Plotësisht
Rrjete të përmirësuara të kanaleve të kullimit	11	11	100	Plotësisht
Rrjete të kanaleve ujitëse të rehabilituara dhe përmirësuara	232	98	42	Plotësisht
Diga të rezervuarëve të rehabilituara pjesërisht	11	4	36	Plotësisht
Diga të rezervuarëve të rehabilituara plotësisht	205	164	80	Plotësisht
Argjinatura të reja të ndërtuara	112	94	84	Plotësisht
Argjinatura të rikonstruktura	20	20	100	Plotësisht
Argjinatura të rehabilituara	60	60	95	Plotësisht

Hidrovore të rikonstruktuar dhe ripërshtatur	9	9	100	Plotësisht
TOTALI	1553	1328	85	

Nga shqyrtimi i ecursisë së shpenzimeve të aktiviteteve të produkteve të Programit 04240 "Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes", e vitit 2014 rezulton se:

Me shpenzimet:

- Janë realizuar aktivitetet (shpenzimet jashtë projekteve), që realizohen me shpenzimet (art.600, 601 dhe 602) .
- Këto aktivitete kanë të bëjnë kryesisht me procesin e mirëmbajtjes së infrastrukturës kryesore të kullimit, ujitjes si dhe mbajtjen në gatishmëri të 28 hidrovorëve shoqëruar kjo me inspektimet e të gjithë infrastrukturës (diga, argjinatura hidrovor etj.)
- Aktualisht janë realizuar të gjithë punimet e mirëmbajtjes në ujitje, biles është avancuar me pastrimin e kanaleve ujitës si dhe gjatë muajit dhjetor 2014 janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në kullim.
- Ka përfunduar remonti i 28 hidrovorëve me përjashtim të hidrovorit të Çasit, pasi ky hidrovor është në proces rehabilitimi të plotë .

Me investimet:

Nga investimet për arsye të procesit gjyqësor u rrezikua realizimi financimi i objektit Kaskada Vashtëmi, me vlerë 52 milion lekë, financim i cili u paksua nga plani nëpërmjet aktit normativ nr.2 , dhjetor 2014.

- **Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes ka realizuar 51 %** . Shkaku i mosrealizimit të investimit të planifikuar: Kontrata e supervizimit të punimeve u lidh 24.11.2014 dhe gjatë muajit Dhjetor që filloi punën supervizori i punimeve, kontraktori i punimeve përgatiti planet topografike dhe programet e punimeve dhe i dorëzoi tek supervizori në mënyrë që ti miratonte dhe të lëshonte urdhërat për fillimin e punimeve në të gjitha digat, supervizori nuk arriti që të lëshonte urdhërat për fillim punimesh dhe kjo solli mosrealizimin e dorëzimit të situacionit të punimeve në kohën e planifikuar. Gjatë gjithë muajit dhjetor është ndjekur procesi me raportim periodik ditor kontraktor-supervizor-MBZHRAU për çdo problem të hasur. Të gjitha aktivitetet e tjera të planifikuara janë realizuar 100% në kohën e përcaktuar.

4. Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”.

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2014, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” ju alokuan gjithsej 1.771.748 mijë lekë dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente 1,459,410mijë lekë
- Shpenzime kapitale 312,338 mijë lekë

Gjatë kësaj periudhë, sipas kërkesave të Ministrisë së Financave kanë ndodhur ndryshime në buxhetin e planifikuar për programin. Këto ndryshime kanë qenë të lidhura, si me rialokimet brenda programit, ashtu dhe me Aktin Normativ, e VKM e dala.

Realizimi sipas produkteve :

Për “ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë”. Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Buajt, Bagëtitë e Imta, si dhe shpenzimet për përmirësimin racor. Me VKM nr.1634 datë 17.12.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”, si dhe urdhërit të Ministrit nr. 84 datë 02.03.2008, janë përcaktuar të gjitha procedurat dhe tarifat për këtë qëllim. Kështu për vitin 2014 u alokuan fonde për buajt prej 3 milion lekë në tre qarqe të vendit atë të Lushnjës, Elbasanit dhe Tiranës. U plotësuan kartelat dhe çertifikatat veterinarë të kafshëve si dhe u mundësua disbursimi i fondeve. Me mosrealizim u paraqitën qarqet e Elbasanit dhe Tiranës, pasi nuk përfunduan në kohë kartelat e kafshëve.

Gjithashtu mbështetur në VKM nr.1708 datë 29.12.2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr.4 datë 18.08.2009; janë parashikuar 1.5 milion lekë, për financimin e racave në rrezik zhdukje në Elbasan dhe Shkodër. Është ecur paralelisht me matrikullimin e bagëtive në këto qarqe si dhe janë disbursuar fondet.

Është parashikuar dhe një fond prej 2.8 milion lekë për përmirësimin racor në DRB-të e 6 qarqeve, me qëllim përmirësimin, regjistrimin dhe rritjen e cilësisë së mishit nga bagëtitë. Ka filluar disbursimi pothuajse në të gjitha qarqet.

Në total produkti është realizuar në masën 78%.

Promovim i produkteve shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, përmes pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare:

Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2014, u planifikuan për mbështetje 4 panaire ndërkombëtare dhe 3 panaire lokale, si dhe promovimi me anë të tregjeve lëvizëse si dhe tregjeve të hapura. Sipas urdhërit të ministrit, për këtë qëllim, u mundësua pjesëmarrja në panirin “Green Eëek 2014”, Berlin Gjermani, si dhe në panairin HORECA, organizuar në Tiranë, për herë të parë.

Festivali i Verës, panairi i Agrobiznesit dhe Turizmit, si dhe panairët lokale, sipas urdhërit të ministrit, u realizuan si një paketë aktivitete në “Muajt e Bujqësisë Shqiptare”. Kjo paketë përmbledhi një sërë aktivitete, të organizuara sipas një kalendari mirë të përcaktuar. Për këtë qëllim u kryen procedurat e prokurimit, duke përfshirë jo vetëm fondin e planifikuar për panairët, por dhe fondet e planifikuara për shpenzimet e statistikës, si dhe ato të planifikuara për ofrim shërbimi për PDO dhe PDI. Kompania e specializuar, në bashkëpunim dhe me miratim, rast pas rasti të Ministrisë, organizojë aktivitetet e planifikuara. Ky organizim pati një efekt mjaft pozitiv, pasi solli një prezantim dhe promovim të produkteve dhe bizneseve si kurrë më parë.

Panairët rajonale u asistuan dhe u mbështetën në organizimin e bizneseve dhe prezantimin e tyre, por pa kosto. Shpenzimet për to u mbuluan nga bashkitë përkatëse dhe donatorë të tjerë të fushës së bujqësisë. Fondi i parashikuar u realizua 96%.

Përmirësimi i infrastrukturës ruale nga Projekti MMP dhe SDRMA; konsiston në ndërtimin e rrugëve rurale, lerava të bagëtive, skemave ujitëse, si dhe dhënie e granteve konkurruese përmes një procedure seleksionimi. Kjo u realizua përmes disbursimit të fondeve të projektit si dhe mbështetjes me Kosto lokale e TVSH nga fondet buxhetore. Fondet e planifikuara për Grantin Francez, nuk janë realizuar si efekt i ndryshimit të stafit. Fondi është realizuar rreth 98%.

Promovimi i teknologjive të reja për mbjelljen, mbledhjen dhe ruajtjen e duhanit, përmes rritjes së sipërfaqes së kultivarëve të çertifikuar, rritje e eksportit dhe e cilësisë; produkt ky i cili realizohet nga Agjensia Kombëtare e Duhan Cigareve. Këtë vit është punuar në drejtim të përmirësimit të prodhimit përmes futjes së kultivarëve të mirë të farës së duhanit për monitorimin tërësor të prodhimit, grumbullim-përpunimit dhe eksportit, përmes promovimit të teknologjive të reja, demonstrimeve, testimeve; etj. Gjithashtu është punuar dhe në drejtim të përditësimit të të dhënave të regjistrit Kombëtar të Prodhuesve të duhanit. Janë grumbulluar mostrat dhe janë kryer degustime. Realizimi i fondit është në masën 93%, pasi për zëra si, plehra kimike, materiale për mbrojtjen e tokës, etj, ka variuar çmimi i tregut. Nga AKDC janë realizuar

të ardhura në shumën rreth 8 099 mijë lekë, kryesisht nga analizat fiziko-kimike dhe degustimi cigareve, nga shitja e grurit të prodhuar në Stacionin e Duhanit Cërrik, nga licencat, etj.

Rritja e sipërfaqes së mbjellë përmes skemave mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë. Për vitin 2014, për skemat mbështetëse është planifikuar (rishikuar) fondi prej 1 146 milion lekë, duke përfshirë këtu dhe fondin e planifikuar si bashkëfinancim në kuadër të projektit IPA 2011. Bazuar në VKM për zbatimin e skemave si dhe udhëzimin përkatës, u krye transferimi i fondeve në Art. 602, për promovimin dhe luftimin e mizës së ullirit. Sipas VKM 294 dhe 506 të 2014, u pakësua fondi me rreth 21.8 milion lekë. Është parashikuar një ndryshim thelbësor në hartimin e skemave mbështetëse, duke i dhënë përparësi jo më mbjelljeve direkte por finalizimit të produktit. Fondi është realizuar në masën 100%. Numri i fermerëve përfitues në total është 8 770 persona. Është punuar me grupet e interesit. Përmes mediave vizive, grupeve të punës, si dhe punonjësve të specializuar, është mundur njohja deri në detaje e skemave mbështetëse, duke rritur kështu numrin e aplikimeve krahasuar me një vit më parë. Financimi i skemave ka filluar në muajin korrik. Janë financuar 38 projekte me normë interes kredie; 95 projekte për serat me ngrohje; 49 projekte me 50% të financimit; 6 988 projekte për mizën e ullirit; si dhe 1 600 projekte për skemat e tjera mbështetëse.

Lidhur me fondin e planifikuar si bashkëfinancim nga projekti IPARD-like, theksojmë se janë financuar 29 subjekte, në investime në fermat bujqësore dhe përpunim tregtim produktesh bujqësore.

Vrojtime statistikore: Për këtë vit u parashikua fondi për kryerjen e vrojtimeve statistikore të Agroindustrisë, si dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit SITA. Ky fond u transferua me urdhër Ministri, për arësye se vrojtimi statistikor u mbulua dhe për këtë vit nga INSTAT dhe printimet nga DB përkatëse. Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit do të kalojnë në vitin 2015.

Rritje në masën 25% e certifikimit të farërave të grurit, misrit, patates dhe perimeve, si dhe rritje prej 10% të analizave dhe testimeve; realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve.

Realizimi i fondit për vitin 2014 është në masën 87%. Gjatë kësaj periudhe është punuar në drejtim të zbatimit të standarteve shqiptare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, mbajtjen e dokumentacionit përkatës, marrjen e mostrave dhe analizave zyrtare dhe dërgimin në laborator, organizimin e punës në grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit për çdo rast në marketingun e farërave dhe fidanëve, marrjen e masave për etiketimin dhe kodifikimin e çdo loti fare të certifikuar, ndërtimin e “Buletinit të Certifikimit” të materialit mbjellës dhe shumëzues

bimor të prodhuar në vend, kryerjen e kontrolleve dhe dhënien e asistencës, përgatitjen e materiale dhe shpërndarjen e Listës së Varieteteve, etj. Janë çertifikuar rreth 23.8 milion rrënjë fidanësh dhe bimësh medicinale, duke tejkaluar kështu planin e parashikimeve. Janë Kryer rreth 661 analiza laborator, etj. Gjithashtu janë kryer testime në 60 hibride misri, 16 varietete patate, 8 varietete gruri, etj. Janë krijuar 11.6 milion lekë të ardhura nga certifikimet, analizat, testimet, etj.

Mbështetje strukturore për zbatimin e të gjitha skemave në bujqësi; përfshihen fondet e planifikuara për Agjensinë e Zhvillimit Bujqësor Rural e cila zbaton skemat mbështetëse në bujqësi. Realizimi i fondeve është 96%. Diferencat kanë ardhur si rezultat i përzgjedhjes së ofertave më të ulta gjatë procedurës së prokurimit.

Rregjistrimi i sipërfaqes me vreshta për 2 000 njësi vreshti (kadastra e vreshtarisë dhe verës). Fondi është realizuar në masën 95%. Me përfundimin e projektit të BE-së për krijimin e kadastrës së vreshtarisë dhe verës, duhet të përfundojë dhe të vazhdojë puna për rregjistrimin e gjithë sipërfaqes së mbetur dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngritur. Për këtë arsye me fondin e parashikuar prej 4 milion lekë për QTTB Fushë-Krujë, gjatë vitit 2014, janë mbyllur rrethet Peqin, Gramsh, Librazhd dhe tre komuna në Elbasan.

Shpenzime për hartimin dhe mirëmbajtjen e kadastrës së ullirit, nga QTTB Fushë-Krujë. Realizuar 100% e fondit të planifikuar. U rregjistruan 2 000 njësi në komunat e Elbasanit.

Shpenzime për serën e fidanëve të ullirit. Fond që menaxhohet nga QTTB Vlorë, në të cilin përfshihen shpenzimet për serën e fidanëve, me qëllim prodhimin e fidanëve cilësorë. Realizimi i fondeve kryhet mbi bazën e situacioneve mujore të shpenzimeve. Fondi është realizuar 80%. Shpenzimet janë kryer për mbrojtjen e tokës, lidhëse fidanësh, kallama, karburant, mirëmbajtje e ullishtes në serrë, etj. Nga planifikimi i bërë nga QTTB ka diferenca në realizim për shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimeve të transportit, e mirëmbajtjes, të cilat janë mbuluar nga shpenzimet korrente të QTTB.

Fuqizimi i kapaciteteve të MBUMK-së, përmes implementimit të projekteve të huaja që veprojnë në këtë fushë. Kështu për vitin 2014 janë planifikuar të veprojnë në këtë program: Projekti IPA 2011; IPA 2012, si dhe IPA Adriatica. Gjithashtu janë çelur dhe fondet për tre projekte të reja në kuadër të Protokollit Italian: Fuqizimi i AZHBR-së, Mbulimi i Rreziqeve në Bujqësi, si dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm i Sektorit të Ullinjve në Shqipëri. Është kryer një shpenzim fondi nga projekti IPA Adriatica për kryerje të aktiviteteve sipas një plani të miratuar.

Nga Projekti Nobles-Ideas kanë përfunduar të gjitha aktivitetet, si dhe është kryer disbursimi fondeve.

- **Projekti IPA Adriatica është realizuar 90 %** , janë kryer aktiviteve sipas një plani të miratuar .
- **Protokollet Italiane , realizim 0** të cilat janë për fuqizimin e AZHBR-së, Mbulimin e Rreziqeve në Bujqësi, si dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Ullinjve në Shqipëri , janë zhvilluar katër mbledhje të komitetit të drejtues sipas axhendës të rënë dakort me palën italiane (ngritja e grupit të punës cili do të ndjekë zbatimin e projektit, termat e referencës për koordinatorët shqiptarë të projekteve, termat e referencës për ekspertët italianë si dhe termat e referencës për kompaninë e auditimit). Janë plotësuar dhe firmosur të gjithë formularët për nënshkrimin e disbursimit të fondeve nëpërmjet Ministrisë së Financave si dhe janë njoftuar të gjithë kandidatët fitues për themelimin e njësive të menaxhimit të projekteve.
- **Projekti IFAD programi zonat malore drejt tregut (MMP-ja) është realizuar 106,3 %**. Janë ndërtuar 25 objekte infrastrukture rurale (rrugë e kanale të vogla ujitëse) e arritur autputet e parashikuara në përputhje me objektivat e projektit. Këto objekte infrastrukture konsistojnë në rehabilitimin e 14 rrugëve rurale me gjatësi prej 31.4 km dhe konstruksioni/ rehabilitimi i 11 skemave kullimi (2 nga të cilat janë sisteme për furnizimin me ujë të pijshëm) me një mbulim zone rreth 321 ha. Numri total i përfituesve është 7000 familje ose rreth 30,400 banorë. Është kryer një material vlerësues, në formën e guidës turistike për dy zona potenciale të turizmit malor, për Vermoshin dhe Valbonën, si bazë për promovimin e turizmit malor. Është përgatitur një plan strategjik për rehabilitimin e sistemit të kullimit në komunën e Bushatit në rrethin e Shkodrës.
- **Projekti për biodiversitetin “Granti Francez” është realizuar 12%** mbasi ky projekt në fillimet e tij ka pasur vonesa sidomos në lidhje me dhënien e miratimit nga donatori lidhur me kontratat.
- **Projekti Nobles-Ideas realizuar 100% për të gjitha aktivitetet.**

12. Shpenzime për serën e fidanëve të ullirit. Fond që menaxhohet nga QTTB Vlorë, në të cilin përfshihen shpenzimet për serën e fidanëve, me qëllim prodhimin e fidanëve cilësorë. Realizimi i fondeve kryhet mbi bazën e situacioneve mujore të shpenzimeve. Si 9 mujor fondi është

realizuar rret 63%. Shpenzimet janë kryer për mbrojtjen e tokës, lidhëse fidanësh, kallama, karburant, mirëmbajtje e ullishtes në serrë, etj.

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi vjetor 2014		
		Në milion lekë	Në %	Statusi i realizimit
Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë (bujt, të imta,)sipas legjislacionit	7.3	6	82	Plotësisht
Promovimi i produkteve shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunuese panaire kombëtare e ndërkombëtare	15	14	93	Plotësisht
Përmirësimi i infrastrukturës rurale përmes ndërtimit të 12 rrugëve rurale; 4 lera bagëtish; 10 skema ujitëse; 120 grande konkurruese (MADA)	286	280	98	Plotësisht
Promovimi i teknologjive të reja për mbjelljen, mbledhjen dhe ruajtjen e duhanit (AKDC)	25	23	92	Plotësisht
Rritja e produktivitetit përmes skemave mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë	1147	1145	100	Plotësisht
Vrojtime statistikore	1,5	1,5	100	Plotësisht
Rritje në masën 25% e certifikimit të farërave të grurit, misrit, patates dhe perimeve, si dhe rritje prej 10% të analizave dhe testimeve (Enti farërave)	27	23	85	Plotësisht
Mbështetje strukturore për zbatimin e të gjitha skemave (AZHBR)	222	212	96	Plotësisht
Regjistrimin e sipërfaqes me vreshta për 2000 njësi vreshti (Kadastra vreshte të verës)	4	4	100	Plotësisht
Regjistrimi i sipërfaqes me ullinj për 2000 njësi (Kadastra e Ullirit)	4	4	100	Plotësisht
Fuqizimi i kapaciteteve të MBZHRAU përmes implementimit të projekteve të huaja(IPA 2011, IPA Adriatica, Protokolli Italian)	26	11	42	Plotësisht
Shpenzime për serën e fidanëve të ullirit	7,2	6	83	Plotësisht
TOTALI	1772	1731	98	

5. Programi “ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor ”

Realizimi i shpenzimeve të 12 – mujorit të vitit 2014, për këtë program që përfaqëson rreth 90% përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 90 përqind
- Shpenzimet kapitale 0 përqind
- **Gjithsej 90 përqind**

Në këtë program në kuadër të PBA-së kanë qenë parashikuar 3 produkte, ecuria e të cilave jepet nga tabela bashkëngjitur.

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi i vitit 2014		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Teknologji dhe paketa teknologjike(elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara	127	117	92	Plotesisht
Ofrim shërbimesh ekstensionit	54	50	93	Plotesisht
Të ardhura të realizuara nga QTTB	33	26	79	Plotesisht
TOTALI	214	193	90	

Në programin “Këshillimi & Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Ekstensionit dhe Informacionit Bujqësor.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) gjatë këtij viti e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar për vitin 2014.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti: Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, janë realizuar në masën 92 % krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2014 janë planifikuar dhe është duke u punuar për të realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elemente të përmirësuar), si dhe 2 studime në fushën e tokave. Në fakt u realizuan 20 paketa teknologjike dhe studime në fushën e tokave bujqësore. Aktivitetet që i shërbejnë produktit janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farave dhe fidanëve, si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Gjatë vitit buxhetor QTTB në zbatim të programeve të miratuara u realizuan gjithsejt 54 eksperimente dhe 28 prova testimi të ndryshme (ku janë krahasuar dhe studiuar 154 varietete bimësh dhe 127 kultivarë) në bazat eksperimentale prodhuese ; janë hartuar 20 karta teknologjike në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.; janë shkruar e publikuar 55 artikuj problemor sipas fushave, kulturave dhe specieve të kafshëve bujqësore.

Produkti: Ofrim shërbime ekstensionit: Shpenzimet për këtë produkt për këtë vit janë realizuar në masën **92 %**. Aktivitetet që i shërbejnë këtij produkti janë: 28 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit,(nga këto kanë përfunduar 28 KnF dhe 11 ishin në vazhdim , trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar (nga 150 ditë persona të Trajnuar të planifikuara për vitin 2014, si vjetor janë realizuar 100 të tilla); si dhe përgatitja dhe shpërndarja e materialeve divulgative për fermerët dhe specialistët e bujqësisë (janë planifikuar dhe po punohet për përgatitjen e 7 tituj broshurash teknike sipas nevojave të fermerëve - të 7 titujt janë përfundim të procesit të shkrimit të tyre).

Produkti : Të ardhura nga QTTB-të të realizuara

Bazuar në Plan bizneset e QTTB-ve për vitin 2014, është punuar për realizimin e të ardhurave, të cilat vijnë kryesisht nga prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, etj.

Përdorimi dhe realizimi i të ardhurave nga QTTB për këtë vit është në masën **25586** mijë lekë nga **32651** mijë lekë që është limiti i përdorimit të këtyre të ardhurave, pra **rreth 93 %**. Gjatë kësaj periudhe, QTTB-të kryejnë kryesisht shpenzime për kryerjen e punimeve bujqësore dhe vënien në punë të hapësirave dhe aseteve që zotërojnë dhe të ardhurat realizohen pas sezonit bujqësor me shitjen e farave të gjeneracioneve të larta (Super-elitë dhe Elitë) dhe fidanëve të pastër, të sigurt nga pikëpamja fitosanitare dhe të kontrolluar e certifikuar.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë këtij viti, strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në qarqe kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panairë, tavolina të rrumbullakëta, etj. Këto aktivitete kanë si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve.

Nga strukturat e Shërbimit Këshillimor janë kontaktuar direkt dhe indirekt dhe kanë marrë informacion gjithsej rreth **75000 fermerë** dhe agrobiznese, nga 70000 fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar **150 ditë trajnime** të hapura me specialistë të bujqësisë si dhe **14500 ditë trajnime** me fermerë të interesuar kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj.

Po kështu, janë shpërndarë për të interesuarit **38000 fletëpalosje** për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, etj. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë në procesin e përgatitjes së 7 titujve të broshurave divulgative në funksion të kërkesave të fermerëve për informacion. Janë realizuar deri tani **156 kronika** dhe **emisione** televizive.

6. Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”

Për vitin 2014, për programin “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore” nga buxheti i shtetit janë parashikuar 20 milion lekë shpenzime operative dhe janë realizuar 20 milion lekë ose 100 % si 12– mujor, për produktin:

1- Krijimi i sistemit të informacionit për tokën LIS dhe integrimi i saj në GIS në 39.218 ha tokë që nga kjo 40.000 ha tokë bujqësore dhe

2- Dixhitalizimi i Regjistrit të Tokës Bujqësore në 41 komuna /bashki në shtatë qarqe të vendit. Realizimi i këtij produktit u krye nga QTTB-ja Fushë-Krujë në bashkëpunim me zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe komunave/bashkive, sipas qarqeve sipas tabelave të mëposhtme:

7. Programi “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014 për këtë program, që përfaqëson **99 përqind** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	91 përqind
• Shpenzimet kapitale	100 përqind
• Gjithsej	99 përqind

Ky program për vitin 2014 ka të planifikuar 900 milion lekë fond investime, nga të cilat 672 milion lekë janë financim i huaj dhe 228 milion lekë financim i brendshëm. Realizimi financiar si vjetor është 100 % .

Janë parashikuar për këtë periudhë 8 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2014 në mln lekë	Realizimi faktik i vitit 2014		
		Në milione lekë	Ne %	Statusi i realizimit
Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore	5	4	80	Plotësisht
Kontrollet e Inspektoratit të Peshkimit në subjektet e peshkimit të liçencuara	23	21	75	Plotësisht
Rasate të peshkimit të kultivuara në Ohër dhe Prespë	9	9	78	Plotësisht
Menaxhimi i infrastrukturës	25	25	50	Plotësisht
Kontrata dhe leje për peshkim	3,5	3,5	23	Plotësisht
Rasate të blera peshq të fam.së krapit	4	0	0	Plotësisht
Kontrolle të ushtruara nga QNOD	10	8	0	Plotësisht
Ndërtimi Portit të ri Peshkimit në Durrës	900	897	100	Plotësisht
TOTALI	979	968	99	

Ky program për vitin 2014 ka të planifikuar 900 milion lekë fond investime nga të cilat 672 milion lekë janë financim i huaj dhe 228 milion lekë financim i brendshëm. Realizimi financiar si vjetor është 99 % .

Realizimi sipas produkteve paraqitet si më poshtë:

Produkti : Akte ligjore dhe nenligjore per burimet peshkore.

Plani për vitin 2014:	5,150 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	4,190.0 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	5 akte	Fakti për vitin 2014 i produkteve:	3 akte

Në mbështetje të ligjit “Për Peshkimin” Nr.64/2012, date 31.5.2012 janë përgatitur Rregulloret të cilat shpërbejnë për menaxhimin sa me të mirë të sektorit.

Produkti : Kontrolle të inspektoriatit të peshkimit në subjektet e peshkimit të liçensuara.

Plani për vitin 2014:	22,900mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	21,130.0 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	1600 kontrolle	Fakti për vitin 2014 i produkteve:	1600 kontrolle

Kontroll inspektive për zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Janë kryer kontrolle inspektive në zbatim të Ligjit Për Peshkimin Nr. 64/2012 dhe në zbatim të Rregulloreve përkatëse. Kontrollet e inspektimit janë kryer në bashkëpunim me inspektoriatet e rretheve.

Produkti : Rasate te peshkimit të kultivuara në Ekonomitë e Linit dhe të Zvezdës

Plani për vitin 2014:	9,042 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	9,042 mijë LEK
-----------------------	----------------	-----------------------	----------------

Plani për vitin i produktit:	1.000.000 rasate	Fakti për vitin 2014	810.000 rasate
------------------------------	------------------	----------------------	----------------

Procesi për vitin 2014 ka përfunduar janë mbledhur 260.000 rasate në ekonomine e Zvezdes dhe 550.000 në ekonomine e Linit. Janë hedhur rastat në Liqenin e Ohrit dhe Prespës për ripopullim.

Produkti : Menaxhimi I infrastrukturës.

Plani për vitin 2014:	24,582 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	24.582 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	4 porte	Fakti për vitin 2014 i produkteve:	4 porte

Janë menaxhuar 4 portet në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë. Janë kontrolluar dhe menaxhuar asetet e porteve dhe është kryer mirëmbajtja e pajisjeve të tyre.

Produkti : Kontrata dhe leje për peshkim.

Plani për vitin 2014:	3,540.0 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	3,500.0 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	350 kontrata	Fakti për vitin 2014:	75 kontrata(Leje)

Në zbatim të kuadrit ligjor janë shqyrtuar për dhënien e lejeve për zhvillim të aktivitetit të peshkimit në det 75 subjekte, nëse këto përmbushin kushtet dhe detyrimet për kryerjen e aktivitetit të peshkimit në det, sipas standarteve të përcaktuara.

Ndërsa në akuakulturë dhe ujrat e brendshëm nuk janë lidhur kontrata gjatë kësaj periudhe.

Produkti : Rasatë të blera peshq të familjes së krapit (ballgjerë, krap kulture, amur).

Plani për vitin 2014:	8000 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	0 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	400000 rasatë	Fakti për vitin 2014 :	0 rasatë

Proçesi i tenderimit nuk është realizuar.

Produkti : Kontrollë të ushtruara nga QNOD.

Plani për vitin 2014:	10.098 mijë LEK	Fakti për vitin 2014:	8,106.0 LEK
Plani për vitin i produktit:	1800 kontrolle	Fakti për vitin 2014 :	

Për kryerjen e një procesi më të mirë monitorimi janë planifikuar të kryhen aktivitetet e QNOD.

Produkti: Ndërtimi I Portit të Ri të Peshkimit në Durrës, me financim nga BIZH

Plani për vitin 2014:		Fakti për vitin 2014:	
Plani për vitin i produktit	900,000 lek	Fakti për vitin 2014 :	897,060 mijë lek

Projekti ka realizim faktik financiar të financimit të huaj 100% , ku të gjitha punimet e lotit I janë 100% , punimet e lotit II janë rreth 90%, punimet e mbetura do të realizohen brenda datës 30 prill 2015.

Nëpërmjet këtij projekti ndërtohet një port strategjik plotësisht operativ ku anijet e peshkimit të shkarkojnë ngarkesën dhe të ankorohen në mënyrë të sigurtë.

Ndërsa për sa i përket investimit të brëndshëm si kosto lokale e tvsh i projektit kanë një realizim 97% dhe 100%.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VOJO BREGU

